

PËLLUMB XHUFI

TURQ QË LUFTOJNË KUNDËR TURQVE

Titullin e këtij artikulli e kemi shkëputur nga një relacion i shkruar në Himarë, nga mitropoliti titullar i Durrësit, Simeon Lascari, më 12 mars 1661. Ky, mes të tjerash, flet edhe për dy fshatra të Labërisë, Dukat e Progonat, të cilët atë kohë kishin ngritur krye kundër Portës së Lartë. “Dukati, shkruan mitropoliti, është një fshat kryengritës me një mijë banorë, të cilët janë myslimanë (*si trova una terra detta Ducades, fà anime due mille, e qui sono anche Turchi ribelli*). Gjithashtu, vazhdon ai, ndodhet aty edhe fshati Progonat, që bën gjithsejt dy mijë banorë; janë myslimanë ... që luftojnë kundër myslimanëve” (*terra detta Progonates, fà anime due mille, Turchi... che combattono contro Turchi*)¹.

Kjo frazë e shkëputur nga relacioni i mitropolitit të Durrësit, prek thelbin e njëres prej temave kryesore të problemit fetar në Shqipëri, asaj të rolit të shqiptarëve myslimanë në lëvizjet antiosmane, më tej në lëvizjen kombëtare, dhe në fund, edhe në krijimin e shtetit shqiptar. Debati mbi këto çështje, që duhet të kishte si premisë të domosdoshme një qasje laike, për fat të keq ndikohet akoma sot nga shtypsi mirëfilli fetar, që e orientojnë atë shpesh në binarë të gabuar e antihistorikë. Kjo vlen më së pari për një pjesë të historiografisë së huaj, e cila, kur flet për myslimanët shqiptarë, thjesht ndjek gjurmët e politikës evropiane të shek. XVI-XIX. Kjo, siç ishte normale për atë kohë, përcaktohej jo pak edhe nga paragjykimet të rendit fetar dhe në këtë kuadër, ajo i njësonte shqiptarët myslimanë me turqit osmanë: shprehja “turq që luftojnë kundër turqve” përbën *summum*-in e absurdit të një qasjeje të tillë, ku një lexues i huaj e ka të vështirë të kuptojë nëse këtu fjala “turk” nënkupton një kategori etnike, apo thjesht një kategori fetare. Ky konfuzion termash, që ka edhe anën tjetër të tij, atë të cilësimit si “grek” të të krishterëve shqiptarë të ritit bizantin, në kohët moderne u manipulua dhe u kthye në

¹ Marco Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. I, Città del Vaticano: 1992, f. 191, 192.

një argument për pretendime nacionale e territoriale². Për shekuj me radhë, oborret e Evropës mesjetare, por edhe qeveritë e Evropës moderne, në planet e tyre për Shqipërinë dhe për Ballkanin, thjesht i injoruan shqiptarët myslimanë, pavarësisht se këta përbënin shumicën e popullsisë në Shqipëri, dhe përfaqësonin një faktor domethënës në zhvillimet gjeopolitike të Ballkanit. Për ta, shqiptarët myslimanë ishin thjesht “turq” dhe si të tillë duheshin trajtuar si pjesë e së keqes, Perandorisë Osmane. Në shek. XV-XVII, por edhe më tej, përpjekjet e Papatit, të Mbretërisë së Spanjës, të Napolit për të ushqyer valët kryengritëse kundër Portës së Lartë, iu drejtuan ekskluzivisht komuniteteve shqiptare të krishtera, ndërkohë që i lanë jashtë projekteve çlirimtare popullsitë myslimane.

Dokumentet e dala nga kancelaritë venedikase, spanjolle, napoletane, franceze, vaticane e më tej, ruse, serbe, greke, i emërtojnë, pra, shqiptarët myslimanë me fjalën “turk”. Përgjithësisht, ky përcaktim nisej nga premisa fetare, pra “turku” ishte myslimani. Në dokumentacionin venedikas të shek. XV-XVIII, “turk” merrte ndonjëherë edhe një konotacion politik dhe me këtë term cilësoheshin shtetasit osmanë. Më 1625, qeveritari i Korfuzit, Piero Marcello, cilësonte si “turq” edhe vetë himariotët, të cilët mund të konsideroheshin të tillë vetëm në kuptimin e “shtetasve turq”³. Në fakt, diku tjetër i gjejmë të quhen saktësisht “shtetas turq të krishterë” (*sudditi Turcheschi Christiani*)⁴.

Po ashtu, në korrik 1558, një korfiot quan “turq” dy banorë të Delvinës, Stamati Psarin dhe xhaxhain e tij, Koçin, të cilët qartazi ishin të krishterë (*Stamatti Psari fratello di questo Dimo, che è in preson, insieme con Cozzì suo barba, ambi dui Turchi*)⁵.

Sigurisht, nga ky rregull i përdorimit të pavend dhe arbitrar të termit “turk”, kishte edhe përjashtime. Kështu, në fund të shek. XVI, veneciani Lazaro Soranzo i konsideronte shqiptarët myslimanë si pjesë të “kombit shqiptar”. Konkretisht, kur flet për Kosovën (Dardania), ai pohon se kjo

² George Castellan, *Histoire des Balkans (XIV^e-XX^e siècle)*, Paris: Fayard, 1991, f. 260.

³ “*li Turchi dalla Cimera seguitano à mettere in essecutione il mercato concluso de frumenti, che in precedenti nostre notificassimo...et ci confermano di adempire la loro promessa, onde come speriamo di star bene de grani*”, Archivio di Stato di Venezia (më tej: ASV), *Dispacci Corfù*, b. 14 (1625-1626): raport i Bajliut Piero Marcello dhe i Proveditorit Paolo Caotorta, Korfuz, 15 mars 1625.

⁴ ASV, *Dispacci Corfù*, b. 12 (1621-1622): raport i Proveditor-Kapitenit Zaccaria Moresin, Korfuz, midis 30 marsit e 30 prillit 1621.

⁵ ASV, *Dispacci Corfù*, b. 2 (1558-1560): dëshmi e Miko Paramauros nga Korfuzi, 19 korrik 1558.

ishte e banuar “më shumë nga shqiptarë, se sa nga serbë”. Me fjalën “shqiptarë” ai kupton sa të krishterët aq edhe myslimanët. E po ashtu, “komandantët turq më të shquar”, vazhdon Soranzo, “i përkasin kombit shqiptar”⁶.

Duhet thënë, gjithsesi, se në dallim nga të huajt, autorët shqiptarë të shek. XVI-XVIII, bëjnë një dallim të qartë mes “turqve etnikë” (*Turchi nazionali*) dhe “turqve shqiptarë” (*Turchi Albanesi*)⁷. Në vitin 1623, Pjetër Mazreku i relatonte Romës se prej 12000 “turqve”, që jetonin atë kohë në Prizren, “thujse të gjithë janë shqiptarë”⁸. Diçka më vonë, ipeshkvi i Shkodrës, Pjetër Bogdani, i quante myslimanët shqiptarë “bashkëkombas” (*conazionali*), duke mos harruar të kujtojë edhe dashurinë që ekzistonte mes tyre e të krishterëve dhe që shpesh rridhte e përforcohej nga lidhjet familjare që ekzistonin mes njeri-tjetrit⁹.

Në një letër, që i drejtohej Inspektoriatit të Tregtisë së Venedikut nga një grup tregtarësh shkodranë, këta të fundit prezantohen në mënyrën më të artikuluar të mundshme, si “myslimanë e të krishterë shqiptarë nga Shkodra” (*noi Turchi e Christiani Scutarini Albanesi*)¹⁰. Në ndonjë rast, ky rektifikim që vetë shqiptarët i bënin raportit të tyre me fenë dhe me kombin, ndikoi edhe tek të huajt. Kështu ndodh, për shembull, në një letër që Inspektoriatit i Tregtisë së Venedikut (*Cinque Savi della Mercanzia*) ia dërgonte Dogjit, më 6 qershor 1699, në të cilën raportohet për një kërkesë që i ishte paraqitur atij Inspektoriatit “nga disa tregtarë shqiptarë myslimanë” (*li punti contenuti nella supplica de mercanti Albanesi Turchi*)¹¹.

⁶ *Dokumente të shek. XVI-XVII për Historinë e Shqipërisë*, vëll. II (1593-1602), përgatiti për botim Injac Zamputi, Tiranë: 1990, f. 227, 233.

⁷ Peter Bartl, *Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte un 17 und 18 Jalahundred*, Wiesbaden, Otto Harrassowitz, 1975, f. 62, 63, 70.

⁸ “*Ha Priseren dunque de Turchi 12000 anime...quasi tutti Albanesi*” (*Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, vëll. I, përgatitur nga Injac Zamputi, Tiranë: 1963, f. 336).

⁹ Kështu, më 1 tetor 1665, Bogdani flet për priftin katolik, dom Pietro Trumshi, i cili kishte marrëdhënie shumë të mira me myslimanët (*i Turchi*): “*con i quali è parente e conazionale, e da loro molto amato*”, shih: M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani*, vëll. I, f. 560.

¹⁰ ASV, *Cinque Savi della Mercanzia: Consoli Veneti in Levante, Durazzo*, serie II^a, b. 28, fasc. 3, 26 novembre 1702.

¹¹ ASV, *Cinque Savi della Mercanzia: Consoli Veneti in Levante, Durazzo*, serie II^a, b. 28, fasc. 1, 2 giugno 1699.

Në atë kohë, venecianët fillojnë të dallojnë sipas kombësisë edhe përfaqësuesit shqiptarë të administratës osmane, të cilët ishin edhe pjesa më e integruar e shoqërisë shqiptare në sistemin osman. Këta, normalisht cilësoheshin thjesht si “turq”. Por me kohë, nga kjo normë ndeshen edhe largime, kur zyrtarë lokalë osmanë fillojnë e përcaktohen sipas kombësisë reale e të veçantë të tyre, dhe jo sipas përkatësisë fetaro-politike osmane. Kështu, në vitin 1704, Inspektoriat venecian i Tregtisë njoftonte se i kishte ardhur një letër e “disa komandantëve myslimanë shqiptarë” (*diversi Commandanti Turchi Albanesi*), të cilët rekomandonin një mikun e tyre të krishterë si konsull tregtar të Venedikut në Durrës¹².

Gjithsesi, rasti i Republikës tregtare të Venedikut është i veçantë. Siç dihet, filli i kuq që udhëhiqte politikën veneciane, ishte ruajtja e rrugëve të lundrimit dhe e tregjeve me vendet e Adriatikut e të Levantit. Një gjë e tillë, pas vendosjes së turqve osmanë në Ballkan, nënkuptonte gjetjen e një gjuhe të përbashkët me zotërit e rinj të atyre vendeve, me turqit osmanë. Marrëdhëniet veneto-turke u normalizuan në një farë mënyre pas paqes së vitit 1479 dhe kaluan deri në një bashkëpunim të hapur, që u shtri deri në fushën ushtarake, kundër fuqive të tjera të krishtera (paqa veneto-turke e vitit 1503)¹³. Kjo ndodhi sidomos pas humbjes së rëndë të pësuar nga ushtritë veneciane në Agnadello, më 14 maj 1509, nga ana e Lidhjes së Cambrais¹⁴. Atë kohë Venediku u afrua aq shumë me Portën e Lartë, sa që vetë Sulltani u shpreh i gatshëm t’i ndihmonte venecianët kundër francezëve, austriakëve dhe principatave të tjera italiane, duke u ofruar atyre ndihma ushtarake tokësore e detare¹⁵. Në fakt, paskëtaj, Venediku do kërkojë mbështetje me drith, madje edhe me ushtarë turq të rekrutuar në sanxhaqet e Vlorës dhe të Moresë ku, siç dihet, shqiptarët përbënin forcën kryesore ushtarake¹⁶. Më 1510, sipas një marrëveshje me turqit, një trupë prej 200 kalorësish të lehtë nën komandën e vojvodës

¹² ASV, *Cinque Savi della Mercanzia: Consoli Veneti in Levante, Durazzo*, serie II, b. 28, fasc. 5, a. 1704.

¹³ N. G. Luzzatto, *Storia economica di Venezia dall’XI al XVI sec.*, Venezia, 1961, f. 230, 254.

¹⁴ Paolo Preto, *Venezia e i Turchi*, Firenze, Sansoni ed., 1975, f. 37.

¹⁵ “*havendo tante potentie contra, non habbi scritto al signor Turco, qual ama la Signoria, e non vol queste cosse, nè vol altri vicini cha Venetiani, offerendosi da mar e di terra*”. M. Sanudo, *Diarii*, VIII, col. 509; P. Preto, *Venezia e i Turchi*, f. 38.

¹⁶ P. Preto, *Venezia e i Turchi*, f. 39-40.

shqiptar Parnava Beut, kaluan në shërbim të Venedikut¹⁷. Gati një shekull më vonë, më 1621, i dërguari i Bajliut venecian të Korfuzit, Jeronim Romani da Vicenza, takoi sanxhakbeun e Gjirokastrës lidhur me një aleancë të mundshme kundër spanjollëve të Mbretërisë së Napolit. Sanxhakbeu u tregua aq miqësor, saqë i ofroi venecianëve ndihma në këmbësorë e kalorës në rast nevoje (*sarebbe sempre pronto alla dovuta corrisponenza dando à V. Ser.tà in ogni occasione di bisogno genti à piedi, et à cavallo*)¹⁸.

Mirëpo ndodhte shpesh që shqiptarët, të krishterë apo myslimanë, nuk pajtoheshin me frymën e miqësisë me Portën, që sundonte në politikën e Venedikut. Kështu, aty nga viti 1480, disa komandantë stratiotësh shqiptarë, si Krokodil Klada, Teodor Bua e Meksha Buziki, që mbronin kështjellat veneciane në Peloponez, nuk e pritën mirë paqen e nënshkruar një vit më parë mes Portës dhe Republikës së Venedikut (*...desorti et mal contenti per questa pace*)¹⁹. Ata vazhduan të sulmojnë trupat osmanë, ndaj me ndërhyrje të komandantëve osmanë, Senati i Venedikut vendosi, më 8 janar 1480, që krerët shqiptarë të shpallehin armiq të Venedikut, të arrestoheshin dhe të ekzekutoheshin²⁰. Në janar të vitit 1670, ishin autoritetet veneciane të Korfuzit ato që i kërkuan ndihmë autoriteteve osmane të Vlorës për kundër banorëve myslimanë të fshatit Dukat, me të cilët kishin hyrë në konflikt. Por, siç shprehej Proveditor-Kapiteni i Korfuzit, Domenico Gritti, mundësia për zgjidhjen e konfliktit me ndërmjetësinë e komandantëve osmanë të asaj zone ishte fare e vogël “pasi dukatasit ishin nga ata shqiptarë që nuk u binden aspak Turqve” (*mà per essere l’istessi di Ducades Albanesi, che non rendono nè tampoco obbedienza à Turchi dubito non ne sortisca l’effetto*)²¹. Shënojmë, që në atë kohë fshati Dukat, ashtu si shumica e fshatrave të Labërisë, ishte islamizuar. Pavarësisht kësaj, banorët e tij vazhdonin të

¹⁷ R. Predelli, *I libri commemoriali della Repubblica di Venezia, Regesti*, vol. VI, Venezia: 1903, nr. 190.

¹⁸ ASV, *Dispacci Corfù*, b. 12: raport i Andrea Bragadin, Bajli, dhe i Zaccaria Moresinit, Proveditor e Kapiten, Korfuz, 30 mars 1621.

¹⁹ C. Sathas, *Documents inédits ou peu connus relatifs à l’histoire de la Grèce au Moyen âge*, vëll. VI, Paris: 1884, f. 120, 129, 148, 153,159; F. Babinger, “Albanische Stratioten im Dienste Venedigs”, në: *Studia Albanica*, nr. 2, Tiranë: 1964, f. 101 e vijim.

²⁰ C. Sathas, *Documents inédits et peu connus ...*, vëll. I, Paris: 1880, f. 273-274.

²¹ ASV, *Dispacci Corfù*, b. 21 (1665-1671): raport i Proveditor-Kapitenit Domenico Gritti, Korfuz, 2 janar 1670.

njiheshin si “myslimanë kryengritës” (*Turchi ribelli*)²². Për më tepër, në Dukat, ashtu si në të gjithë trevën e Himarës (Labërisë), ndodhte shpesh që kryengritësit myslimanë të bashkoheshin me ata të krishterë. Kështu, më 12 mars 1661, peshkopi ortodoks Simon Laskari raportonte nga Himara se “i gjithë ky vend ka ngritur krye kundër turqve, madje ka aty fshatra e kështjella ku kryengritës myslimanë janë bashkuar me kryengritës të krishterë” (*tutto questo paese è ribelle de Turchi, però tra queste terre e castelli di questa provintia vi sono anche Turchi ribelli uniti con li Christiani*)²³.

Megjithatë, këto kryengritje asnjëherë nuk u mbështetën, dhe në projektet çlirimtare të Mbretërisë së Napolit për Shqipërinë, Greqinë e për Dalmacinë, në shek. XVI-XVII, nuk gjejmë as edhe një rast të vetëm që shqiptarët myslimanë të përfshiheshin në to²⁴. Dokumentet e shumta, që flasin për rekrutime të luftëtarëve shqiptarë nga ana e Mbretërisë së Napolit apo e Republikës së Venedikut, në shek. XV-XVIII, provojnë se këto fuqi nuk pranuan të rekrutojnë shqiptarë të besimit mysliman, ndërkohë që kërkonin vazhdimisht të rekrutonin luftëtarë shqiptarë të besimit të krishterë. Rastet e pakta që përmendëm më lart, që kishin të bënin me rekrutimin e luftëtarëve shqiptarë myslimanë nga ana e Republikës së Venedikut, me sa duket përbëjnë një përjashtim. Domethënës është, në këtë drejtim, rasti i një prifti nga Himara, Vasil Varfit, i cili ishte angazhuar personalisht në mbledhjen e rekrutëve himarjotë për llogari të Mbretit të Napolit. Aty nga viti 1760, ai arriti të bindë shtatë ushtarakë, që shërbenin në ushtrinë osmane, të dezertonin dhe të arratiseshin në Napoli²⁵. Me siguri bëhej fjalë për subjekte të besimit mysliman nga fshatrat e islamizuara të krahinës së Himarës (Labërisë). Ne nuk dimë gjë për fatin e tyre të mëtejshëm, por mund ta marrim me mend atë, në rast se kemi parasysh një tjetër rast të ngjashëm. Në vitin 1807, një farë *Brahim Seiti* nga Zhulati (Gjirokastër), mysliman,

²² Kështu, në vitin 1661, dëshmohet se “*si trova una terra detta Ducades, fà anime due mille, e qui sono anche Turchi ribelli*”, shih: M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani durante la guerra di Candia (1645-1669)*, vëll. I, Città del Vaticano, 1992, f. 191, 192.

²³ M. Jačov, *Le missioni cattoliche nei Balcani ...*, I, 1992, f. 185.

²⁴ P. Bartl, *Westbalkan zwischen spanischen Monarchie und osmanischen Reich*, Wiesbaden: Otto Harassowitz, 1974.

²⁵ P. Preto, *I servizi segreti di Venezia*, f. 341. Prifti Vasil Varfi, i tradhëtuar nga një bashkëpunëtor i tij, në vitin 1770 ra në duart e Proveditorit të Përgjithshëm të Detit, i cili organizoi vdekjen e tij nëpërmjet një helmi me veprim të ngadalshëm.

erdhi në Napoli dhe u regjistrua në repartin e njohur të të ashtuquajturve “këmishkuq” shqiptarë (*camiciotti*), pjesë e “Regjimentit Mbretëror Maqedonas”, të formuar vetëm me shqiptarë të krishterë. Por, përpara se të pranohej në atë repart, ky person u detyrua të ndryshojë besimin e të pagëzohej në kishë²⁶.

Ashtu si venecianët, edhe napoletanët vetëm në raste të veçanta dhe vetëm në Shqipëri mund t’i pranonin shërbimet e individëve të caktuar të besimit mysliman. Edhe atëherë bëhej fjalë më shumë për “veprimtari zbulimi” ose për “akte eversive”, si ai i vitit 1595, kur agjentë napoletanë përgatitën një plan për të pushtuar me një aksion të beftë qytetin e Ulqinit. Plani mbështetej në ujdinë me një ulqinak mysliman, Hysen Avdullain, i cili kundrejt një shpërblimi, kishte marrë përsipër të hapte portën dhe të lejonte futjen në qytet të një grupi kryengritësish shqiptarë të armatosur²⁷.

Edhe regjimi i kapitulacioneve, që fuqitë evropiane ia imponuan Portës së Lartë duke filluar nga fundi i shek. XVII, i cili i siguronte mbrojtjen e së drejtës së ushtrimit të fesë e më tej, njohjen e autonomive lokale për popullsitë e krishtera shqiptare, i linte krejtësisht jashtë vëmendjes popullsitë shqiptare myslimane, të cilat thjesht konsideroheshin si pjesë e universit osman. Paragjykimet me sfond fetar, që përcaktuan këtë qasje të diferencuar ndaj të krishterëve e myslimanëve shqiptarë, më vonë frymëzuan edhe projektet për copëtimin e shtetit shqiptar, apo për organizimin e tij mbi bazën e kantoneve. Akoma më shumë, ato ndikuan shpeshherë edhe për të përkeqësuar marrëdhëniet midis komuniteteve të ndryshme fetare në Shqipëri. Në fakt, në kohën e betejave për mëvetësi dhe për shtet kombëtar, që në Shqipëri kulmoi me Lidhjen e Prizrenit (1878), shqiptarët myslimanë u bënë protagonistë të kryengritjeve por edhe të lëvizjes së madhe kulturore që i shoqëroi ato. Mbi këtë bazë, edhe shumë vëzhgues të huaj denoncuan politikën e

²⁶ M. Sciambra, “Prime vicende della comunità greco-albanese di Palermo e suoi rapporti con l’Oriente bizantino”, në: *Bolletino della Badia Greca di Grottaferrata*, 16, 1962, f. 101.

²⁷ “*et quanto a Dulcigno habbiamo trattato con un Turcho che prima era Christiano, nominato Ussain Abdulla, habitante a Dulcigno et è in territorio di Croia, di darli 300 ducati et lui ne dava in ostagio doi suoi figliuoli promettendosi di aprir la porta del detto luogo, quella della marina, et lassar prima entrar di giorno alquanti Albanesi dentro con le armi*”, shih: Jovan Tomić, *Grača istoriju pokreta na Balkanu protiv turaka krajem XVI i početkom XVII veka*, knj. I (1595-1606), Beograd: 1933, f. 6.

diferencuar të zbatuar nga kanceleritë evropiane, të bazuar mbi paragjykimet fetare, dhe nënvizuan rolin vendimtar të myslimanëve në fatet e kombit shqiptar. Kështu, në fund të shek. XIX, gjeoetnologu italian Antonio Baldacci, vërente se “*pikërisht myslimanëve u detyrohet fakti që çështja kombëtare shqiptare mori një impuls që deri dje i mungonte krejt*”²⁸. Po atë kohë, më 1898, studiuesi dhe albanologu austriak Theodor Ippen, i cili jo rastësisht pas disa vitesh u emërua si këshilltar i delegacionit austro-hungarez në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, e kritikonte politikën e “Kultusprotektoratit” të zbatuar nga Monarkia Austro-Hungareze në Shqipëri kur deklaronte “*ne kemi rënë vazhdimisht në gabimin, që e kemi konsideruar Shkodrën dhe viset katolike të Veriut, sikur të ishin e gjithë Shqipëria*”²⁹.

Plotësisht të ndërgjegjshëm për pasojat fatale që mund të kishin për çështjen kombëtare shqiptare politikën e diskriminimit e të përjashtimit mbi baza fetare ishin aktivistët e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Këta e refuzuan dhe e luftuan me forcë çdo qasje, që ekzaltonte rolin e fesë dhe që binte ndesh me projektin e tyre për një shtet unitar, e pra laik, të ngritur sipas ideve të Jean Jacques Rousseau e të iluministëve të tjerë. Mbi këtë bazë, ishin patriotë të vijës së parë, si Vaso Pasha, Thimi Mitko, Anselmo Lorecchio, Ndre Mjeda, Nikoll Ivanaj, Hil Mosi, të gjithë të besimit të krishterë, të cilët u hodhën me forcë e me pasion për të mbrojtur, faqe Evropës, shqiptarinë e vëllezërve të tyre myslimanë. “*Maometant e Shqipëris jan më të mirët patriotët*”, shkruante më 20 prill 1886 patrioti Thimi Mitko³⁰. Përpara tij, më 1847, arbëreshi Vincenzo

²⁸ Antonio Baldacci, *Itinerari Albanesi (1892-1902)*, Roma: 1917 (=Tiranë: Argeta, 2004), f. 116.

²⁹ “*Wir sind andauernd in dem Irrtume verstrickt, Scutari und das katholische Nord-Albanien für ganz Albanien zu erhalten*”. Shih: A. Wernicke, *Theodor Anton Ippen. Ein österreichischer Diplomat und Albanienforscher*. Albanische Forschungen 7. Wiesbaden (Otto Harrassowitz) 1967, f. 34, 59.

³⁰ Letër e Thimi Mitkos për De Radën, botuar tek “*Fiamuri i Arberit*” viti III, nr. 12, 20 prill 1886. Pikërisht për të thyer paragjykimet e perëndimorëve ndaj shqiptarëve myslimanë, në një konferencë të mbajtur në Romë më 1911, N. Ivanaj lëshohej në një ditiramb plot pasion për vëllezërit e tij myslimanë: “*Evropa e ashtuqajtur e qytetëruar i gjykon myslimanët shqiptarë të ndryshëm nga ata të krishterë. Por kjo është fare e padrejtë, pasi shqiptarët edhe në qofshin me fe të ndryshme, janë gjithnjë vëllezër dhe kanë tradita, zakone e gjuhë të përbashkët. Madje dua të theksoj, se Shqiptarët myslimanë janë më të mësuar se ata të krishterë dhe se vetë banorët e Kosovës, që mbahen për të egër e injorantë, janë sot më të moralshëm dhe më nacionalistë se shumë shkodoranë katolikë*”, shih: N. Ivanaj, *Conférenza tenuta in*

Dorsa kishte botuar veprën *Su gli Albanesi. Ricerche e pensieri*, të cilën në mënyrë kuptimplotë ai ia dedikon “*Kombit tim të ndarë dhe të shpërndarë, por që është një*”. Aty, Dorsa ndërton një panteon të heronjve shqiptarë të të gjitha kohrave, ku krahas Aleksandrit të Madh, Pirros e Skënderbeut, përfshin edhe myslimanët Mehmet Aliu, Ali Pashë Tepelena e Ibrahim Pasha³¹. Dorsa nuk mund ta dinte, se një tjetër shqiptar, Halil Patrona nga Opari, komandant jeniçerësh, më 1729 guxoi të organizojë një kryengritje pallati në vetë zemrën e Perandorisë, Stamboll, duke rrëzuar nga fronti Sulltan Ahmetin dhe duke vendosur në vend të tij Sulltan Mahmudin³². Sigurisht, do të ishte e sforcuar dhe jo realiste të përfshiheshin këta emra në listën e atyre personaliteteve shqiptare që punuan për pavarësinë e Shqipërisë dhe për krijimin e shtetit shqiptar. Por veprimtaria e tyre në kapërcim të shek. XVIII-XIX tronditi rëndë themelet e Perandorisë Osmane duke krijuar kushtet për emancipimin jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të popujve të tjerë.

Në fakt, njësimi në fe me pushtuesit osmanë nuk arriti t’i njësonte myslimanët shqiptarë me pushtuesit dhe nuk i pengoi ata të ngrinin krye kundër tyre. Në vitin 1607, një organizator shqiptar i kryengritjeve antiosmane, Pal Dukagjini, njoftonte Dogjin e Venedikut për një lëvizje kryengritëse të drejtuar nga Idar Maneshi, mysliman shqiptar nga malësia e Krujës, i cili bashkë me tremijë trima, kishte ngritur krye në malësitë e

Roma all’Associazione della Stampa Italiana, 26 gennaio 1911, Roma, Comitato Italiano “Pro Albania”, 1912, f. 15; Vassa Effendi, *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët. Studim historik*, përkthim dhe komentim prej Mehdi Frashërit, Tiranë: 1935 (sipas botimit francez, Paris: 1879), f. 97, 101; *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, vëll. I (1879-1908), përgatiti për botim Z. Haskaj, Tiranë: 1971, f. 117, 168. Nga ana e tij, Anselmo Lorecchio shprehej: “*Quanti siamo Sqipetari sulla Terra, siamo tutti dello stesso sangue, parliamo la stessa lingua. Uniamoci tutti, fratelli Sqipetari, non siano più le religioni cagione di dissidio tra noi. Diffidiamo dunque di tutti gli stranieri, diffidiamo di tutti i falsi ministri della religione. Dio e Allah, Maometto e Cristo una sola via a noi additano: tenere unita e rispettata la patria nostra*”, shih: F. Guida, *Ricciotti Garibaldi e il movimento nazionale albanese*, in: “Archivio Storico Italiano”, anno CXXXIX, disp. 1, Firenze 1981, f. 107; M. Quku, *Mjeda*, vëll. I, Tiranë: Ilar, 2004, f. 523; vëll. II, Tiranë: 2006, f. 129, 323; vëll. III, Tiranë, 2007, f. 55, 56, 70, 72, 450.

³¹ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë: Përpjekja, 2012, f. 158-159.

³² J. Hammer, *Geschichte des Osmanischen Reiches*, vëll. 7: von Carlowicz bis zum Belgrader Frieden (1699-1739), Pest, 1831, f. 381, 382, 391, 392; Pëllumb Xhufi, *Shekulli i Voskopojës (1669-1769)*, Tiranë: Toena, 2010, f. 237.

Dukagjinit, Kthellës e Selitës: Maneshi, sipas relatorit, pretendonte se do të përsëriste bëmat Skënderbeut³³. Në fakt, kryengritja e Idar Maneshit dëshmohej të ketë qenë më masivja e kapërcimit të shek. XVI-XVII. Ky njoftim ka rëndësi, dhe jo vetëm për faktin që dëshmon se nervi kryengritës kundër pushtuesve osmanë gjallonte fort edhe ndër shqiptarët myslimanë. Shumë interesant rezultoi edhe raporti i tyre me figurën e Skënderbeut. Dihet tashmë, se Skënderbeu mbeti edhe në shek. XVI-XVIII një figurë referenciale për të krishterët shqiptarë, katolikë e ortodoksë. Që nga shek. XVI e deri në shek. XVIII, burime të ndryshme dëshmojnë se himarjotët e quanin Skënderbeun “mbretin” e tyre³⁴. E po ashtu, më 1607, Mark Gjini krenohet me faktin që gjyshi i tij kishte luftuar nën urdhrat e Skënderbeut³⁵. Por, është akoma më mbresëlënëse fakti që figura e Skënderbeut mbetet edhe për kryengritësit shqiptarë myslimanë një referencë e lavdishme historike. Këta dy elementë i

³³ Letër nga Budva e Pal Dukagjinit për Dogjin e Venedikut, 1 maj 1607: “*et di novo essendo un Turcho per nome Idar Manesi sopra Croia, infra montagne, forse seguito di gente et si avea lasato dire che vuol esser un altro Scanderbeg...et detto Idar Manesi subito fece tremilia valentomini soldati et andò nella provincia di Duchagini et di Chela et Selitta unidi insieme tutti et giurati esser contra il Turcho*”. Shih: J. Tomić, *Grača za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI i početkom XVII veka*. (Srpska kraljevska Akademija. Zbornik za istoriju, jezik i književnost sprskog naroda, drugo odeljenje, kniga VI), knj. I, god. 1595-1606, Mletački državni arhiv, Beograd, 1933, nr. 251, f. 438.

³⁴ Letër e himarjotëve për Gregorin XIII, 12 korrik 1577: “*Notum tibi sit, Sanctissime Pater, quod olim ex quo tempore ad Deum migravit fortissimus et serenissimus Scanderbech, noster Rex, cognomento Castriones*”, shih: I. Zamputi, *Dokumente*, vëll. I, f. 340. Më 1 qershor 1593, himarjotët i shkruanin papës Klementi VIII: “*per molestar il Gran Turco, sicome fu molestato al tempo del nostro Principe Giorgio Schanderbeg...combatteremo non meno che al tempo del sudetto Principe Giorgio*”, shih: M. Jačov, *I Balcani tra Impero Ottomano e potenze europee (sec. XVI e XVII)*, Città del Vaticano, 1995, f. 75 shën. 99. Edhe pas 200 vjetësh, më 1759, në promemorien e tyre për carinën e Rusisë, Elizabeta Petrovnën, himarjotët vazhdonin të identifikoheshin kombëtarisht me Pirron e Epirit dhe me Skënderbeun. Shih: *Dokumente të pabotuara mbi marrëdhëniet e popullit shqiptar me Rusinë në shek. XVIII*, në: “Buletin i Shkencave Shoqërore”, Tiranë 1955, nr. 2, f. 158. Atë kohë (1760), edhe kapiteni Spiro Bixhili, nga Dhërmiu, duke folur për shqiptarët deklaronte se “*ajo racë ka ruajtur të njëjtin shpirt si në kohët e vjetra të Skënderbeut*”. Shih: G. Arš, *E Allvania kai e Epeiros sta tele tou IH' kai stes arches tou IΘ' aiona*, Athena: Gutenberg, 1994, f. 73, 76.

³⁵ J. Tomić, *Grača za istoriju pokreta na Balkanu protiv Turaka krajem XVI i početkom XVII veka*, knj. I, god. 1595-1606, Mletački državni arhiv, Beograd: 1933, nr. 253, f. 447-9.

konfirmon më së miri edhe kleriku katolik shqiptar, i mirënjohuri Pjetër Bogdani. Në një letër të tij të 20 tetorit 1658, Bogdani shpreh shpresën e madhe, se bëmat e dikurshme të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, do mund t'i përsëriste në kohët e reja ndonjë prijës mysliman, i shquar për vullnetin, ndjenjat dhe veprat e mira, i cili do vihej në krye të kryengritësve shqiptarë, si dikur Skënderbeu³⁶. Vendin qendror të figurës së Skënderbeut, si simboli i qëndresës kundër pushtimit osman, e konfirmon në vitin 1610, edhe Arqipeshkvi i Tivarit, Marin Bici. Sipas tij, bëmat e Kastriotit kundër turqve tregoheshin e këndoheshin në tubimet e besimtarëve katolikë, ku shpesh herë ishin të pranishëm edhe myslimanët³⁷.

Kryengritja e Idar Maneshit nuk ishte as e para dhe as e fundit. Kryengritje antiosmane raportohen në Bastar dhe në Kurjan të zonës së Krujës, në vitet 1565 e 1574³⁸.

Një kryengritje e fuqishme shpërtheu para vitit 1586 në dervenllëkun e madh të Kaçanikut. Kryengritësit shqiptarë myslimanë kishin dëbuar me atë rast garnizonin dhe administratën osmane dhe, madje, kishin vrarë edhe kadiun osman. Vlen të theksohet, se atë kohë, me kryengritësit ishin bashkuar edhe shumë *rajà* të krishterë³⁹. Paskëtaj, Porta e Lartë urdhëroi ndërtimin e një kalaje në Kaçanik, për të mbajtur nën kontroll popullsinë e atyre anëve⁴⁰. Akoma më masive dëshmohet kryengritja e banorëve myslimanë të krahinave të Dibrës e të Tetovës, që vazhdoi nga viti 1592 deri në 1595. Numri i kryengritësve arriti në 10 mijë vetë⁴¹.

Më 1606, në Lopës të Kurveleshit u ngritën banorët dhe kryengritja u shtri në të gjithë krahinën. U dëbua administrata osmane dhe dy

³⁶ “*Si potrebbe non dimeno, un giorno caggionar qualche gran bene a questa città quando qualche renegato studioso, et abituato in qualche bona opera, et sentimento divenisse capo d’esserciti come successe sotto Amurate in Giorgio Castriotti detto Scanderbeg*”, shih: Pjetër Bogdani. *Letra dhe Dokumente*, përgatiti për botim O. Marquet, Shkodër: Gjergj Fishta, 1997, f. 84.

³⁷ “*Nella chiesa sudetta dicono esser sepolto il famoso Alessandro Castrioto, chiamato per altro nome Scanderbegh, che si segnalò con tante valorose fattioni contra Turchi, le quali ridotte in versi si cantano in quella lingua da tutti gl’Albanesi in presenza anco dei Turchi*”. Shih: I. Zamputi, *Relazione ...*, vëll. I, f. 110.

³⁸ Selami Pulaha, *Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shek. XVI deri në shek. XVIII. Dokumente osmane*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1978, f. 73, 91.

³⁹ *Po aty*, f. 99.

⁴⁰ *Po aty*, f. 97.

⁴¹ *Po aty*, f. 100.

sanxhekbejlerë që kishin ardhur për të shtypur kryengritjen mbetën të vrarë⁴². Më 1638 në Elbasan plasi një kryengritje e madhe, e drejtuar nga një prej krerëve të familjes Biçakçiu, të cilin Sulltani e shpalli “tradhëtar të fesë dhe të shtetit tim”⁴³. Një kryengritje e banorëve të Margëllicit më 1668, e pasuar nga ajo e banorëve të Delvinës, shkaktoi zemërimin e Sulltanit, i cili dërgoi për shtypjen e tyre një ekspeditë me 12 mijë ushtarë.⁴⁴ Rreth dhjetë vjet më parë, banorët e Delvinës ishin ngritur përsëri. Në atë rast delvinjotët kishin refuzuar të paguanin një taksë të re arbitrare, ishin hedhur në kryengritje dhe kishin kërcënuar, madje, se do vrisnin pashain e tyre (*gl’habitant di Delvino habbiano ricusato di corrispondere l’ultima tansa imposta, e che quel Bassà, volendo essercitare qualche rigore contro i disubidenti, sia stato astretto à ritirarsi, minacciando di voler privarlo di vita*)⁴⁵.

Më 1703, ajanë myslimanë nga Mati bashkë me të krishterë nga Selita dhe Macukulli ngritën krye dhe sulmuan kalanë e Stelushit⁴⁶. Në 1703 u ngritën kundër Portës banorët e Progonatit e të Kardhiqit. Me kryengritësit u bashkua edhe dizdari i kalasë së Tepelenës, Muço Hyso, i cili ishte imponuar në këtë post që në vitin 1698, pasi kishte udhëhequr një kryengritje të 300 banorëve të krishterë të asaj treve⁴⁷. Brenda vitit 1704 kryengritja përfshiu gjithë krahinën e Kurveleshit dhe për shtypjen e saj valiu i Rumelisë mobilizoi të gjithë komandantët e ejaletit, duke përfshirë edhe Hydaverdi Pashën, që atë kohë ishte mytesarif i sanxhakëve të Shkodrës, Dukagjinit e Prizrenit⁴⁸. Ndonjë vit më parë, ky kishte arritur të shtypte një kryengritje të fuqishme në krahinat e Kolonjës, Oparit dhe Përmetit⁴⁹. Krahinat e Kurveleshit, Kolonjës e

⁴² *Po aty*, f. 106.

⁴³ *Po aty*, f. 115.

⁴⁴ “...gli abitanti di Margariti stesso, che per le loro innobbedienze han provocata l’indignatione del Gran Signore à farle provare il suo rigore. Hora s’hà per più costituiti, che habbino à calare à Delvino ancora dodeci mille d’essi Turchi per ponere pure in dovere quegli Albanesi loro sudditi”, ASV, *Dispacci Corfù*, b. 31 (1665-1671): raport i i Proveditor-Kapitenit të Korfuzit, Gerolamo Dolfin, 14 dhjetor 1668.

⁴⁵ ASV, b. 29 (1657-1661): raport i Lorenzo Sagredos, Proveditor e Kapiten i Korfuzit, 25 gusht 1658.

⁴⁶ S. Pulaha, *Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman*, f. 228.

⁴⁷ *Po aty*, f. 238.

⁴⁸ *Po aty*, f. 223, 226, 227, 231, 233.

⁴⁹ *Po aty*, f. 281.

Përmetit u bënë teatër kryengritjesh të mëdha edhe në vitin 1707. Por vatrën e tyre duket se këto kryengritje e kishin tek lëvizjet e banorëve myslimanë të Margëlliçit e Paramithisë në Çamëri, të cilët prej disa vitesh kishin zënë kështjellat e refuzonin të njihnin administratën osmane⁵⁰. Disa vite më vonë, më 1714, 1500 kryengritës nga Margëlliçi sulmuan kështjellën dhe dëbuan funksionarët osmanë⁵¹.

Në vitin 1756, një aleancë interesante u krijua midis kryengritësve myslimanë të Margëlliçit dhe komandantëve të katër anijeve nga Ulqini. Këta të fundit vunë në dispozicion të margëlliçiotëve anijet e tyre për të kryer një inkursion kundër trupave osmanë që ishin dërguar për shtypjen e tyre⁵².

Kuptohet, atëherë, pse Pjetër Bogdani, më 1658, edhe pse pa u ndarë nga vizioni i tij kristian, i shihte shqiptarët myslimanë si pjesë esenciale të luftës për çlirimin e vendit nga sundimi osman. Njëllon me të, më 1621, Pjetër Budi deklaronte se midis kushurinjeve e miqve të tij më të ngushtë, kishte edhe disa dinjitarë myslimanë (*principali Turchi*), që ishin të gatshëm t'i bashkoheshin projektit të tij për çlirim nga zgjedha osmane⁵³.

Summary

TURKS THAT FIGHT AGAINST THE TURKS

The process of islamization made an important part of the Albanian population identify spiritually and culturally with the Ottoman conquerors. Historians, chroniclers, clerks and travelers from Europe have shown a great

⁵⁰ *Po aty*, f. 239-244.

⁵¹ *Po aty*, f. 301, 303.

⁵² “*Grave e molesta si va rendendo vieppiù la scritta insurrezione dei Popoli Margariti contumaci della Porta li di cui andamenti e tutte le apparenze dimostrano che sia per verificarsi la meditata loro aggressione nel Xeromero, tengono in grand'apprensione il Comandante Ottomano di quella Provincia (Querini, fol. 103 r). Si sentono in ora confermati pure gli stani effetti dell'intelligenze tenute da essi Margariti con li Rais di quatro tartare Dulcigniote per agevolarsi per ogni via possibile lo sbarco nelle dette parti Ottomane anche delle genti ammassate in loro rinforzo e raccolte da altre vicine bande della Turchia*”, Biblioteca Querini, Cl. IV, cod. 360: *Dispacci di S. E. Sig. r Girolamo Querini Gentiluomo à Corfù*, t. I, fol. 103^{rv}.

⁵³ I. Zamputi, *Dokumente të shek. XVI-XVIII për Historinë e Shqipërisë*, vëll. III, nr. 211, f. 381, 385.

interest in this process, to such a scale that they started to call the Albanian Muslims simply as “Turks”. According to them, this religious and cultural identification with the “Turks” was valid also in ethnic terms. In their distorted view, everything related to the Albanian Muslims, even the uprisings against the Sublime Porte, did not deserve any attention and was seen simply as internal issues of the “Turkish” world.

The misuse of the term “Turk” as an ethnic name to denominate the Muslim Albanian, happens frequently even in the European historiography of the 19th-20th centuries, leading to big confusions and misunderstandings, that on the other hand have been used by some of the Balkan nationalist ideologies. Thus, Albanian personalities and historical events have not been treated as such, leading to a trend of unjustified contraction and minimization of the history of the Albanian people. This differentiated cultural approach towards the Albanians is based on prejudices of religious nature, which have conditioned not only the attitudes of the intellectuals but also of the European chancelleries from the 15th century.

It is not by accident that the Albanian Muslims and their anti-ottoman uprisings did not attract the interest of the European powers and were never supported by them. On the other hand, the Albanian authors themselves, such as Pjetër Bogdani, Pjetër Mazreku etc., made a clear distinction between the “the ethnic Turks” (*turchi nazionali*) and the “Albanian Turks” (*turchi albanesi*). Pjetër Bogdani called these later “conationals” (*connazionali*). Similarly, a group of merchants from Shkodra identified themselves before the Venetian authorities in 1702 saying clearly: “We the Shkodran Albanians, Turks and Christians”. (*noi Turchi e Christiani Scutarini Albanesi*).

Documentary evidence shows that, quite different from the European chancelleries, in the 16th-18th centuries the Christian Albanians considered their Muslim conationals as an essential part of their projects of uprising against the Ottomans. From this viewpoint, two well-known Albanian personalities of the 17th century, Pal Dukagjini and Pjetër Bogdani, both of them Catholics, saw the salvation of Albania from the Ottoman yoke, only through the appearance of a second Scanderbeg, who, according to them could not be other than a Muslim.